

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"DAMA" SHPK

Bazuar në ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me vullnetin e tij të lirë, te shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot me date 21.10.2024, themeluesi;

Z. Sead Llukaj, i biri i Abdi dhe i Sadete, i datelindjes 23.03.1985, lindur dhe banues ne Durres ne adresen : Lagjja Nr. 14, Rruga "Bajram Tusha", ish "Agroeksporti", Shkozet, Durres s, identifikuar me karte identiteti nr ID: I50324012V

deklaron se ka vendosur te nenshkruaj kete akt themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**DAMA**" SHPK (me poshte refereruar si shoqeria). Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti dhe legjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare.

Neni 1-Emertimi

Shoqeria emertohet "**DAMA**" SHPK. Emertimi i shoqerise mund te shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

Neni 2-Selia

Selia zyrtare e shoqerise ndodhet ne **Lagjen nr 6, Rruga "M.Mujo", Objekt me nr. pasurie 3/273-N2, Zona Kadastrale 8513, Durres**. Organi i asamblese se shoqerise sipas parashikimeve te këtij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund te transferoje ne cdo moment seline zyrtare te shoqerise, po ashtu mund hape si ne Shqiperi dhe jashte saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

Neni 3- Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete pa afat, duke filluar prej dates se rregjistrimit te saj ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qendes Kombetare te Biznesit.Ky afat mund te ndryshohet nje ose me shume here, me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 4- Objekti i veprimtarise

Objekti i shoqerise eshte si me poshte:

- *Aktivitet ne fushen e tregtimit (shit blerjeve) te automjeteve te llojeve dhe tipeve te ndryshme, dhenien e tyre me qira,ose ne perdorim.*
- *Aktivitet ne fushen e sherbimeve : Promovimi i eventeve,rrjeteve dhe aktiviteteve turistike,kulturore dhe historike, manaxhimi i pasurive i strukturave, te enteve dhe rrjeteve turistike, kulturore, artistike, fetare ne teritorin shqiptar.Promovimi turistik i territoreve dhe i objekteve te trashegimise dhe pasurise kulturore per llogari te enteve lokale dhe institucioneve qendrore dhe te cdo subjekti privat.*
- *Aktivitet ne hapje dhe shfrytezim hotelesh, baresh, restorantesh, dyqanesh me karakter te ndryshem, të marrë me qera, të ndërtojë apo të nxisë ndërtimin e tyre, duke vepruar në këtë fushë e vetme apo me partnerë të tjerë.*
- *Aktivite ne fushen e organizimit dhe drejtimi i struktures akomoduese, Aktivitet si operator qe ofron/mundeson per vizitoret e turistet veprimtari informuese, orientuese, argetuese etj.*



- *Aktivitet ne fushen e agjensive imobiliare me targim e ndermjetesimit ne shitjen apo qeradhenien e pasurive te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tjeter te lidhur drejtepse drejti apo terthorazi qe ka te beje me administrimin dhe menaxhimin ne forma te ndryshme te pasurive te paluajtshme.*
- *Tregtim- Import - Eksport i te gjitha mallrave industriale, elektronik, hidrosanitare, bujqesore, blegtorale, artikuj te konsumit te gjere duke perfshire ketu edhe produktet per restorante, bar-kafe, etj, produkteve gjysem te gatshem, konfeksioneve te ndryshme per te rritur e femije, pajisje elektroshtepiake, artikuj kozmetike, produkte mobiljesh, produkte me natyre kozmetike per perdorim hotelerish, qendrash estetike etj.*
- *Transport kombëtar e ndërkombëtar te mallrave dhe udhëtareve per vete e te trete.*
- *Tregtimi me shumicë dhe me pakicë i aksesorëve dhe i materialeve ndihmëse të nevojshme dhe që janë në funksion të aktivitetit.*
- *Shoqëria mundet te realizoj cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

Neni 5- Kapitali i Rregjistruar

Kapitali i rregjistruar i shoqerise eshte 10.000 leke (Dhjetë mijë) leke. Kapitali i rregjistruar eshte i perbere nga 1 kuote me vlere nominale 10.000 leke.

Neni 6- Kuotat e Kapitalit te Rregjistruar

Kuotat e kapitali themeltar te regjistruar zoterohen ne vleren 100% nga ortaku i vetem z. **Sead Llukaj**, i biri i **Abdi** dhe i **Sadete**, i datelindjes 23.03.1985, lindur dhe banues ne Durres ne adresen : **Lagjja Nr. 14, Rruga "Bajram Tusha", ish "Agroeksporti", Shkozë, Durres**, identifikuar me karte identiteti nr ID: 150324012V

Neni 7- Kuotat dhe kalimi i i kuotave te kapitalit

Zoterimi i kuotave, menyrtat e fitimit dhe kalimit te kuotave, pjesimi dhe transferimi i tyre do te behen sipas procedurave te parashikuara ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqerise.

Neni 8- Administrimi

Shoqëria administrohet nga nje administrator, qofte ky edhe jo ortak i cili emerohet ose shkarkohet nga asambleja e pergjithshme. Administratori qendron ne postin e tij per 5 (pese) vjet, me mundesine per tu rizgjedhur. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar brenda fushes se administrimit te zakonshem qe kane lidhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji apo statuti i jep Asamblese duke perfshire delegimin e kompetencave edhe personave te tjere me prokure te posacme.

Administratori i pare i shoqerise eshte ortak i vetem i shoqerise z. **Sead Llukaj, i biri i Abdi dhe i Sadete, i datelindjes 23.03.1985, lindur dhe banues ne Durres ne adresen : Lagjja Nr. 14, Rruga "Bajram Tusha", ish "Agroeksporti", Shkozë, Durres , identifikuar me karte identiteti nr ID: 150324012V** madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai ose cdo person tjeter i autorizuar prej tij do te ndjeke te gjitha procedurat e nevojshme per rregjistrimin e shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit(QKB).

Neni 9- Te tjera



Shoqëria do ta ushtroje aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shperblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 10

Te gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakut dhe Shoqërisë si dhe midis kësaj të fundit dhe administratorit do të diskutohen në mënyrë të drjetperdrejte midis të interesuarëve për t'u zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 11

Dispozita me të detajuara mbi organizimin e kësaj shoqërie perkufizohen në statutin e tij. Ortaku i vetëm pasi e lexon me vëmendje kontratën dhe e gjen atë sipas vullnetit të tij, e nënshkruan atë.

Ky Akt Themelimi është përgatitur në 4 kopje.

Durrës, më datë 21.10.2024

THEMELUESI

SEAD LLUKAJ

